

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 8451/4, datë 5.1.2015

PËR ÇAKTIMIN E ÇMIMIT DHE TARIFAVE TË BOTIMEVE TË QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE, SI DHE INSTITUCIONET QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË BOTUARA TË FLETORES ZYRTARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr.78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Çmimi i shitjes së botimeve (përfshirë edhe Fletoren Zyrtare) llogaritet si prodhim i çmimit për një faqe, me numrin e faqeve të botimit. Çmimi për një faqe është 7 (shtatë) lekë.
2. Për botimet me lidhje speciale, çmim total i botimit do të jetë i barabartë me çmimin e rezultatit të prodhimit (7 lekë për nr. faqesh) plus 300 lekë.
3. Çdo subjekt i interesuar mund të bëjë abonim vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a.
4. Botimet (përfshirë edhe Fletoren Zyrtare) mund të shiten drejtpërdrejt nga Qendra Botimeve Zyrtare me çmimin e vendosur në kapak. Pagesa bëhet në llogarinë bankare zyrtare të Qendrës.
5. Çmimi i abonimit vjetor pranë “Posta Shqiptare” sh.a., për Fletoren Zyrtare, është 20 000 (njëzet mijë) lekë.
6. Çmimi i shitjes së botimeve për libraritë dhe agjencitë shpërndarëse llogaritet me një zbritje prej 5% mbi çmimin e llogaritur sipas pikës 1, të këtij urdhri (kur ky aktivitet pasqyrohet në objektin e aktivitetit tregtar të këtij subjekti tregtar).
7. Çmimi i shitjes së serive të Fletoreve Zyrtare në CD-ROM për secilin vit, është 5000 (pesë mijë) lekë.
8. Konsultimi i akteve të botuara në Fletoren Zyrtare në faqen zyrtare të internetit është falas.
9. Për konfirmimet dhe kopjet e akteve të caktuara, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për fletë.
10. Për shumëfishime të Fletores Zyrtare të numrave të kaluar, jashtë tirazhit të përcaktuar, do të zbatohet çmimi 20 (njëzet) lekë për faqe.
11. Shpërndarja e Fletores Zyrtare, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet me kontratë me “Posta Shqiptare” sh.a., e cila mban 10% të vlerës së abonimit.
12. Institucionet që përfitojnë falas kopje të botuara të Fletores Zyrtare, janë ato të përcaktuara sipas ligjeve të posaçme.
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

NDREQJE GABIMI

1. Në vendimin nr. 10, datë 6.12.2013 të Bordit të Komisionerëve “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, datë 3.3.2014, faqe 481, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Ishte: Vendimi nr.10, datë 6.12.2013 “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë”

Bëhet: Vendimi nr. 10, datë 6.2.2014 “Mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e furnizuesit publik me shumicë”.

2. Në vendimin nr. 60, datë 7.7.2014 të Bordit të Komisionerëve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014 mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, datë 11.8.2014, faqe 5828, bëhet korrigjimi si më poshtë vijon:

Ishte: Në vendimin nr. 60, datë 7.7.2014 “Mbi kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 90, datë 6.2.2014, mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Bëhet: Mbi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014, mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe propozimit “Për rishikimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë nga KESH sh.a.”

3. Gjithashtu në vendimin nr. 60, datë 7.7.2014 të Bordit të Komisionerëve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014 mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, faqe 5828, në pjesën referuese të bazës ligjore të bëhet ndryshimi si më poshtë:

Ishte: Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar dhe nenit 26 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike, lidhur me kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr. 9, datë 6.2.2014, “Mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Bëhet: Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike, të ndryshuar dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 7.7.2014, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike, lidhur me kërkesën nr. 3277 prot. datë 20.3.2014 të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a. për rishikimin e vendimit nr.9, datë 6.2.2014 “Mbi një shtesë në rregulloren “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe propozimit të CEZ Shpërndarje sh.a. “Për rishikimin e rregullave dhe procedurave të blerjes së energjisë nga KESH sh.a.”.